



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 176, datë 21.12.2020

PËR

MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM PA KUNDËRSHPËRBLIM, TË PRONËS NR. 99, ME EMËRTIM “ISH REPARTI USHTARAK NR 5011/45”, ME VENDNDODHJE NË SURREL, FARKË, TIRANË, SHOQATËS SË INVALIDËVE PARA&TETRAPLEGJIKË

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “a” dhe pika 1/1.2, shkronja “a”, nenit 24, pikat 1 dhe 3, nenit 54, shkronja “e” dhe nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; nenet 901-912, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, të ndryshuar, ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 478, datë 17.06.2020, të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në pronësi nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Tiranë, të një sipërfaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve brenda territorit të pronës nr.99 me emërtim ish Reparti Ushtarak nr 5011/45 me vendndodhje Surrel, Farkë, Tiranë dhe vendimit nr 515, datë 18.07.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes””, të ndryshuar, Memos me nr. 44176/1, datë 15.12.2020, “Për vijimin e procedurave për miratimin e dhënies në përdorim të ambientit të pronës nr.99, me emërtim “Ish reparti ushtarak nr. 5011/45, vendodhja në Surrel, Farkë, Tiranë, Shoqatës së Invalidëve Para & Tetraplegjikë ”, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë dhënien në përdorim pa kundërshtëpërblim për një periudhë 10-vjeçare, të pronës me nr. 99, me emërtim "Reparti ushtarak nr. 5011/45", me sipërfaqe trualli Str. = 3300m² dhe sipërfaqe ndërtimi Snd. = 466,2 m², me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë (sipas hartës treguese të Regjistrimit), Shoqatës së Invalidëve Para & Tetraplegjikë të Shqipërisë.
2. Ndalohet dhënia në përdorim të tretëve dhe ndryshimi i destinacionit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.
3. Ngarkohet kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej tij për nënshkrimin e kontratës së huapërdorjes midis Bashkisë Tiranë dhe Shoqatës së Invalidëve Para & Tetraplegjikë.
4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO